



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.351/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar, Mejreme Memaj e Agim Maliqi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarës Sh.M., nga fshati S., komuna e I., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, parashikuar me nenin 409 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarës, paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog P.nr.307/2018 datë 7 nëntor 2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me 24 dhjetor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarës Sh.M., paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog P.nr.307/2018 datë 7 nëntor 2019.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P.nr.307/2018 datë 7 nëntor 2019, e pandehura Sh.M., është shpall fajtor për veprën penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, parashikuar me nenin 409 par.1 të KPRK për të cilën është gjykuar me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ekzekutimi i të cilit është shtyrë për 1 (një) vit, me kusht që e pandehura pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit brenda kësaj periudhe mos të kryej vepra penale.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së të pandehurës Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkitazi me ankesën, me aktgjykimin PA1.nr.1570/2019 datë 22 shtator 2020 e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Kundër aktgjytimeve të lartcekura ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë e dënuara, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Ndaj kërkesës së të dënuarës është përgjigjur Kryeprokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.194/2020 datë 17 dhjetor 2020 me propozim që kërkesa të hudhet si e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e dënuara pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal për faktin se deklaratat e policëve ishin shpifëse, ishin të njëjta edhe pse nuk ishin të gjithë në vendin e njëjte të ngjarjes, kurse deklaratat e saj ishte ngushtuar dhe gjyqtari nuk e kishte lenë të shprehej lirshëm, dhe nuk ishte bërë ekspertiza e kërkuar për verifikim të ngjarjes. Pastaj sipas të dënuarës meqë kjo çështje nuk është gjykuar drejtë edhe dënimi i shqiptuar është shumë i rendë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme nuk janë të bazuara. E dënuara me kërkesë thekson se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal por nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur, kurse nga përmbajtja e kërkesës del se e konteston gjendjen e fakteve. Sipas dispozitës së nenit 436 par.1 të KPP me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por nuk mund të supozoj se çka ka dashur të thotë pretenduesi. Kurse, pretendimet sa i përket gjendjes faktike dhe vendimit për dënim nuk qenë objekt shqyrtimit ngase sa i përket këtyre bazave ligjore kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet (neni 432 i KPP).

Përveç kësaj pretendimet në kërkesë sa i përket gjendjes faktike nuk e venë në dyshim saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara me vendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa.

Nga arsyet e lartcekura kjo Gjykatë vlerëson se kërkesa nuk është e bazuar, kurse konform dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.351/2020 datë 24 dhjetor 2020

Procesmbajtësi
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit
Rasim Rasimi